

VENDIM
Nr. 644, datë 2.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 412, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RISHIKIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 412, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
- a) tabelës bashkëlidhur vendimit i hiqet numri rendor 5 (pesë), me bashkëpronarë z. Batjar Bazaj dhe znj. Luiza Xhaho, me numër pasurie 36/191/ND, zonë kadastrale 8602, me vlerë kompensimi 618 577 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë;
- b) në pikat 3 dhe 4, vlerës së përgjithshme të kompensimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, i zbritet vlera prej 618 577 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh. Vlerës së shpenzimeve procedurale i shtohet vlera 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që do të përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- c) ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT PËR "NJË NDRYSHIM NË VKM-në NR. 412, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RISHIKIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS"

Nr.	Nr. rendor në VKM-në nr. 412/20136	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas	ISHTE		BËHET		Shënime
						Sip. e shpronësuar në VKM-në 412/2016 (m²)	Vlera në VKM-në 412/2016 (lekë)	Sip. Shpron.Arë m²	Vlera	
1	5	Batjar	Bazaj	8602	36/191/ND	31.89	618,577	0	0	Pasuria nr. 36/191/ND, z.k. 8602, në bashkëpronësi të z.Batjar Bazaj dhe Luiza Xhaho, miratuar në VKM-në nr. 412, datë 01.06.2016, me nr. rendor 5, e cila nuk preket nga vija e shpronësimit, në vlerën 618 577 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, hiqet nga shpronësimi, duke bërë edhe korigjimin në VKM-në e sipërcituar.
		Luiza	Xhaho							
Vlera totale e shpronësimit							618,577		0	

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit					Firma
Nr.	Emër	Mbiemër	Detyra funksionale		
1	Artan	Shkreli	Kryetar		
2	Etleva	Malile	Anëtar		
3	Vjollca	Bazaiti	Anëtar		

4	Arvenola	Naumi	Anëtar
5	Besmira	Nuredini	Anëtar